RAPORTI I PUNËS

Janar – mars 2026

Përmbajtja

RAPORTI I PUNËS 1
HYRJE 3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 4
DEPARTAMENTI I FINANCAVE 5
DEPARTAMENTI SHITJE DHE MARKETING 8
KONTROLLI I CILËSISË DHE SIGURISË USHQIMORE 10
DEPARTAMENTI I SHËRBIMEVE TË PËRBASHKËTA 12
ZYRA E BURIMEVE NJERËZORE 15
VËZHGIMI NË TERREN NË ÇERDHE DHE SHKOLLA 17
MENAXHIMI I KONTRATAVE 19
PËRFUNDIME 21

HYRJE

Ky raport paraqet aktivitetet, rezultatet dhe performancën e NPL Ku'zina sh.a. gjatë Tremujorit të Parë (TM1) të vitit 2026, për periudhën **1 janar – 31 mars 2026**. Raporti është përgatitur në funksion të informimit të Bordit të Drejtorëve dhe Aksionarit mbi realizimin e objektivave të ndërmarrjes, performancën financiare dhe operative, si dhe zhvillimet kryesore që kanë karakterizuar këtë periudhë.

Raporti është hartuar në përputhje me Statutin e NPL Ku'zina sh.a., aktet e brendshme të ndërmarrjes dhe legjislacionin në fuqi që rregullon funksionimin e ndërmarrjeve publike, duke pasqyruar punën e departamenteve dhe njësive organizative përgjegjëse për realizimin e aktiviteteve të ndërmarrjes.

Gjatë Tremujorit të Parë 2026, NPL Ku'zina sh.a. ka vazhduar të ofrojë shërbime të përgatitjes, prodhimit dhe shpërndarjes së ushqimit për institucionet parashkollore, shkollat fillore të përfshira në programin e mësimit terë ditor, Qendrën për Persona të Moshuar, qendrat sociale, Brigadën e Zjarrfikësve, si dhe për klientë të tjerë institucionalë dhe privatë, duke garantuar vazhdimësi, cilësi dhe siguri ushqimore në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat ligjore.

Përveç paraqitjes së rezultateve financiare dhe operative, raporti ofron një pasqyrë të aktiviteteve të realizuara nga secili departament, përfshirë menaxhimin e kontratave, prokurimin, kontrollin e cilësisë dhe sigurisë ushqimore, burimet njerëzore, monitorimin në terren dhe shërbimet mbështetëse. Gjithashtu, raporti analizon sfidat e hasura gjatë periudhës raportuese, masat e ndërmarra për adresimin e tyre dhe prioritetet strategjike për tremujorin vijues.

Qëllimi i këtij raporti është të ofrojë një vlerësim të plotë dhe objektiv të performancës së ndërmarrjes, duke mbështetur procesin e vendimmarrjes, forcimin e transparencës dhe llogaridhënies, si dhe planifikimin e aktiviteteve dhe investimeve për periudhën në vijim. Nëpërmjet analizës së treguesve kryesorë të performancës dhe rezultateve të arritura, raporti synon të demonstrojë angazhimin e NPL Ku'zina sh.a. për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve, përdorimin efikas të burimeve dhe përmbushjen e misionit të saj në shërbim të institucioneve dhe qytetarëve të Kryeqytetit.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i Tremujorit të Parë (TM1) 2026 paraqet performancën e NPL Ku'zina sh.a. gjatë periudhës janar–mars 2026 dhe dëshmon vazhdimin e trendit të rritjes së ndërmarrjes, si në aspektin financiar ashtu edhe në zgjerimin e shërbimeve, përmirësimin e proceseve operative dhe forcimin e kapaciteteve organizative.

Periudha e parë e vitit 2026 ka arritur vlerën e shitjes 741,236.92 euro. Rritja e të hyrave ka ndodhur më së shumti në muajin Mars të këtij viti si rezultat i rritjes së numrit të vijueshmërisë së fëmijëve pranë Institucioneve Parashkollore Publike dhe Publiko-private dhe përfundimin e pushimeve pranverore të Institucioneve Parashkollore.

Në këtë periudhe të vitit të kaluar (2025), të hyrat kanë qenë 595,159.75 euro.

Në TM1 të vitit 2026 kemi 146,077.17 euro më shumë të hyra krahasuar me vitin 2025. Kurse te hyrat nga operatorët privat janë rritur për 4,889.62 euro krahasuar me vitin paraprak. Totali i të hyrave nga sektori privat është 9,964.88 euro.

Paralelisht me rritjen e të hyrave, ndërmarrja ka përballuar edhe rritjen e shpenzimeve operative, të ndikuara nga zgjerimi i aktivitetit, rritja e numrit të punonjësve, investimet në zhvillimin institucional dhe shtimi i nevojave për lëndë të parë. Megjithatë, struktura e shpenzimeve reflekton investime të drejtpërdrejta në rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, duke krijuar bazë të qëndrueshme për zhvillimin afatgjatë të ndërmarrjes.

Në aspektin operacional, NPL Ku'zina sh.a. ka garantuar furnizim të pandërprerë me ushqim për institucionet parashkollore, shkollat fillore me mësim tërë ditor, qendrat sociale, Qendrën për të Moshuarit dhe Brigadën e Zjarrfikësve. Numri i shujtave të shpërndara është rritur ndjeshëm, ndërsa është evidentuar gjithashtu rritje e porosive private, duke dëshmuar zgjerimin gradual të aktivitetit dhe besimin në shërbimet e ndërmarrjes.

Siguria ushqimore ka mbetur një nga prioritetet kryesore të ndërmarrjes. Gjatë TM1 janë realizuar monitorime të vazhdueshme sipas sistemit HACCP, analiza laboratorike të ushqimit dhe ujit, kontrolle higjieno-sanitare dhe inspektime operative, pa u evidentuar asnjë rast kontaminimi apo devijimi nga standardet e kërkuara. Këto rezultate konfirmojnë funksionimin efektiv të sistemit të kontrollit të cilësisë dhe krijojnë bazë solide për procesin e certifikimit sipas standardeve HACCP dhe ISO 22000.

Në fushën e prokurimit dhe menaxhimit të kontratave është siguruar funksionim i qëndrueshëm i proceseve të furnizimit, janë nënshkruar kontrata me vlerë **232,710.50 euro** dhe është monitoruar zbatimi i **27 kontratave aktive**. Veçanërisht vlen të theksohet reagimi i menjëhershëm institucional ndaj ankesave për cilësinë e bukës, duke ndërprerë kontratën ekzistuese dhe duke siguruar furnizim të ri me standarde më të larta cilësore.
Në planin organizativ, ndërmarrja ka vazhduar investimin në burimet njerëzore përmes riorganizimit të stafit, punësimeve të reja dhe programeve të zhvillimit profesional. Njëkohësisht janë ndërmarrë masa për standardizimin e proceseve operative në terren, përmirësimin e disiplinës organizative dhe rritjen e cilësisë së shërbimit në të gjitha pikat e servimit.

Në tërësi, rezultatet e Tremujorit të Parë 2026 dëshmojnë se NPL Ku'zina sh.a. ka hyrë në një fazë të konsolidimit institucional dhe të rritjes së qëndrueshme. Përkundër zgjerimit të konsiderueshëm të aktivitetit dhe sfidave që sjell ky zhvillim, ndërmarrja ka arritur të ruajë stabilitetin financiar, të

garantojë cilësi dhe siguri ushqimore, të përmirësojë efikasitetin operacional dhe të forcojë kapacitetet menaxheriale.

Prioritetet strategjike për tremujorin e dytë do të jenë përfundimi i procesit të implementimit të programeve të trajnimit dhe mentorimit për certifikimin HACCP dhe ISO 22000, zgjerimi i kapaciteteve prodhuese, forcimi i monitorimit të kontratave dhe performancës së operatorëve ekonomikë, përmirësimi i infrastrukturës dhe pajisjeve, si dhe zhvillimi i mëtejshëm i shërbimeve në funksion të përmbushjes së nevojave në rritje të institucioneve dhe qytetarëve të Kryeqytetit.

DEPARTAMENTI I FINANCAVE

Departamenti i financave në periudhën raportuese ka luajtur një rol të shumëfishtë në përfshin menaxhimin e aseteve financiare të ndërmarrjes, planifikimin financiar, dhe sigurimin e qëndrueshmërisë ekonomike. Roli i këtij departamenti mund të përmblidhet në funksionet e mëposhtme kryesore siç është planifikimi financiar dhe buxhetimi, kontabiliteti dhe raportimi financiar si dhe kontrolli i kostove dhe efikasiteti operativ. Gjatë periudhës raportuese, departamenti ka luajtur një rol të rëndësishëm në sigurimin e qëndrueshmërisë financiare dhe rritjes se ndërmarrjes.

Të ardhurat dhe fitimet

Periudha e parë e vitit 2026 ka arritur vlerën e shitjes 741,236.92 euro. Rritja e të hyrave ka ndodhur më së shumti në muajin Mars të këtij viti si rezultat i rritjes së numrit të vijueshmërisë së fëmijëve pranë Institucioneve Parashkollore Publike dhe Publiko-private dhe përfundimin e pushimeve pranverore të Institucioneve Parashkollore.

Në këtë periudhe të vitit të kaluar (2025), të hyrat kanë qenë 595,159.75 euro.

Në TM1 të vitit 2026 kemi 146,077.17 euro më shumë të hyra krahasuar me vitin 2025. Kurse te hyrat nga operatorët privat janë rritur për 4,889.62 euro krahasuar me vitin paraprak. Totali i të hyrave nga sektori privat është 9,964.88 euro.

Shitje TM1 2026	**IP, QS, SHP,BZ**	**Op.Privat**	**Totali**
Janar	208,504.66	1,372.88	209,877.54
Shkurt	250,335.59	1,744.91	252,080.51
Mars	272,431.78	6,847.09	279,278.87
Total	731,272.04	9,964.88	**741,236.92**

Krahasim i shitjeve		
TM1 2024	*TM1 2025*	*TM1 2026*
301,482.85	595,159.75	741,236.92

Viti 2024 periudha TM1- Shitjet kanë arritur vlerën në 301,428.85 euro, kurse në periudhën e njejtë të vitit 2025 shitjet kanë arritur ne vlerë 595,159.75 euro që në % rezulton me rritje prej 97.4%. Pothuajse kemi dyfishim të të hyrave krahasuar më vitin 2024.

Kurse krahasuar vitin 2025 me vitin 2026 kemi një rritje me të ngadalshme prej 24.5%.

Viti 2026	**Paga Bruto**
Muaji Janar	84,657
Muaji Shkurt	84,159.9
Muaji Mars	84,927.3
Totali për tre muaj	253,741.2

Krahasim i buxhetit të Pagave		
TM1 2024	*TM1 2025*	*TM1 2026*
134,686.07	201,718.87	253,741.2

Nga viti 2024 kemi rritjet të shpenzimeve për paga në vitin 2025 për 49.8%. Kurse prej viti 2025 në vitin 2026 kemi rritje të ketyre shpenzimeve të pagave për 25.8%. Keto shpenzime krahasuar me të hyrat që kemi pasur nder vite, janë rritur me një trend të lartë në fillim pastaj është ngadalësuar mirepo asnjere pa i tejkaluar të hyrat.

Shpenzimet

Në tabelën me poshtë janë paraqitur llojet e shpenzimeve të ndodhura gjatë këtij tre mujori të parë të vitit 2026

Në vitin 2025 vlera totale e shpenzimeve për këtë periudhe ka qenë 262,163.26 euro.

Në këtë periudhë të vitit lënda e parë vazhdon të mbetet zëri i cilli mër pjësë më 55% në totalin e shpenzimeve. Qeraja e objektit është një shpenzim fiks i cili merr pjësë me 9.44%, duke u percjellur nga shpenzimet e brendimit me 8% shpenzim ky që ndryshon varësisht kërkesës së ndermarrjes.

Procedura e cila vazhdon është shndërrimi i veturave frigo që për këtë periudhë është 5% si një shpenzim teknik operativ relativisht i lartë. Blerja e aseteve, inventari per objektin e ri aktivitet ky që lidhet me bartjen në objektin e ri merr pjesë me 4.5% të shpenzimeve.

Veturat me qira gjithashtu janë një zë i rëndesishëm i shpenzimeve fikse në ndermarrje që merr pjese me 4.20%.

Trajnime dhe avanvime në ketë periudhë arrijnë 3.32% të totalit të shpenziemeve. Kemi edhe shpenzime të vogla nën 1% si nafta, shpenzimet e telefonit, higjiena, transporti dhe rryma. Mirëpo vlene të permedet që keto shpenzime të faturara janë vetëm të objektit që është në renovim sepse faturimi nga bartja në objekt të ri ende nuk ka filluar. Minimizimi i kostos mund të koncentrohet vëtem në shpenzimet e medha, meqë qiraja është fikse atëhere koncentrimi mund të jetë tek shpenzimet e lendës së parë. Shohim qe mujain Mars kemi pasur rritje të ketyre shpënzimeve mirepo krahas janë rritur edhe numri i shujtave të prodhura dhe shitjet, andaj fokusi duhet të jetë kontrolli i lendës së parë nga humbjet e mundshme. Si një ndermarrje me veprimtari prodhuese operative struktura e ketyre shpenzimeve na tregon që fitimi varet shumë nga kostoja e inputit.

Në muajin Janar kemi pasur më shumë shpenzime të cilat janë rritur me rritjen e investimeve: blerje të inventarit dhe brendim. Kurse muajt pasues kemi pasur një rënie të shpenzimeve dhe rritje të të hyrave.

Tabela e shpenzimeve

	Janar	Shkurt	Mars	Totali
Totali i shpenzimve	**187,956.52**	**139,726.49**	**155,462.35**	**483,145.36**
Lënda e parë	65,281.34	99,912.46	100,777.23	**265,971.03**
Shpenzime për naftë	756.92	760.46	1,315.15	**2,832.53**
Shpenzime për telefon	85.79	78.81	17.06	**181.66**
Shpenzime për trajnime-avancim	16,050.00			**16,050.00**
Shpenzime të interneti	65.88	50.85	50.85	**167.58**
Shpenzime të rrymës	3,451.00	482.92	35.71	**3,969.63**
Shpenzime pë material shpenzues	7.63	264.53	39.15	**311.31**
Shpenzimet për zyre	42.20	176.58		**218.78**
Shpenzimet e reklamës dhe revistave	200.00		20.00	**220.00**
Shpenzimet e higjienës	1,883.09	334.75	122.88	**2,340.72**
Shpenzimet e mirëmbajtjes se veturave,sigurimi dhe servisim	1,672.47	1,386.37		**3,058.84**
Shpenzimet e shenderrit te veturave ne frigo	8,177.97	8,177.97	8,177.97	**24,533.91**
Shpenzimet e paketimeve	905.93	1,618.64	5,830.51	**8,355.08**
Shpenzimet e GPS-ve			101.69	**101.69**

Shpenzimet e veturave rent	6,766.10	6,766.10	6,766.10	**20,298.30**
Shpenzimet e transportit	771.78	771.78	853.02	**2,396.58**
Shpenzimet e analizave IKSHPK			1,343.00	**1,343.00**
Shpenzimet e sigurimit shendetsor	2,042.50	2,067.30	2,067.30	**6,177.10**
Shpenzimet e brendimit	42,140.00			**42,140.00**
Shpenzimet e inventarit per objektin e ri	22,033.89			**22,033.89**
Shpenzimet e qeras se objektit	15,203.39	15,203.39	15,203.39	**45,610.17**
Shpenzimet e mirembajtjes se objektit DDD	418.64			**418.64**
Shpenzimet e mirembajtjes se objektit NPB			6,677.56	**6,677.56**
Shpenzimet e qeras se kompjutereve		1,673.58	1,673.58	3,347.16
Shpenzimet e udhetimeve jasht vendit			386.62	386.62
Paisje per zyre TV (Aset)			3,305.08	3,305.08
Paisje per zyre Telefona			698.50	698.50

Krahasim i shpenzimeve		
TM1 2024	*TM1 2025*	*TM1 2026*
121,387.57	262,163.26	483,145.36

Përmbledhje:	**Të hyrat**	**Shpenzimet**	**Pagat**	**Fitim/Humbje**
Janar	209,878	187,956	84,657	-62,735
Shkurt	252,080	139,726	84,157	+28,197
Mars	279,279	155,462	84,927	+38,890


DEPARTAMENTI SHITJE DHE MARKETING

Gjatë kësaj periudhe të raportimit, departamenti i ka kryer të gjithë detyrat dhe përgjegjësit për të cilat është i thirrur.
Është bërë përgatitja e rregullt mujore e specifikacioneve të shujtave të cilat dërgohen në baza të përditshme në Institucionet Parashkollore (IP), Qendrat Sociale, BPZ Zjarrfikësit, Qendrën Sociale për të moshuar dhe Shkollat Fillore.


Është bërë përgatitja mujore e specifikacionit dhe konstatimit për përgatitjen e faturës që i dërgohet Komunës, sipas Kontratës në shtëpi, të nënshkruar me Komunën e Prishtinës.
Ndërmarrja ka vazhduar shpërndarjen e shujtave ushqimore për Institucionet Parashkollore Publike dhe ato me bazë në komunitet, Shkollat Fillore, Qendrat Sociale Aktash dhe Tophane, Qendrat Sociale për të moshuar dhe BPZ Zjarrfikësit.

Më poshtë, mund të gjeni edhe tabelat e shpërndarjes së shujtave për tre mujorin e parë të vitit 2026.

	Janar	Shkurt	Mars
Institucionet Parashkollore Publike	26711	32454	35729
Institucionet Parashkollore me bazë në komunitet	14295	16360	18060
Qendrat Sociale	5100	5700	6300
Qendra Sociale për të moshuar	6066	5406	6027
BPZ Prishtinë (zjarrfikësit)	2211	1873	1380
Shkollat Fillore	65460	82819	90697
Shërbimet Catering	-	2 organizime 110 persona	-
Porosit private	492 porosi	747 porosi	2090 porosi



Krahasuar me të njëjtën periudhë (TM1) të vitit të kaluar, ndërmarrja ka shënuar rritje të shitjeve private në baza ditore, ndërsa është evidentuar një rënie e ndjeshme në shërbimet e cateringut. Gjatë kësaj periudhe janë organizuar gjithsej 2 kokteje rasti për 110 persona.



	Janar	Shkurt	Mars
2025	1475	801	388
2026	492	747	2090

KONTROLLI I CILËSISË DHE SIGURISË USHQIMORE

Gjatë tremujorit të parë, Njësia për Kontrollin e Cilësisë dhe Sigurisë Ushqimore ka realizuar monitorimin sistematik të proceseve të prodhimit dhe shpërndarjes së ushqimit, me qëllim garantimin e përmbushjes së standardeve të sigurisë ushqimore, procedurave të sistemit HACCP dhe kërkesave ligjore në fuqi.

Fokusi i aktivitetit ka qenë monitorimi i parametrave kritikë të procesit, verifikimi i kushteve higjieno-sanitare, kontrolli i lëndëve të para dhe produkteve të gatshme, si dhe mbikëqyrja e pajisjeve dhe infrastrukturës së prodhimit.

Aktivitetet kryesore të realizuara

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar këto aktivitete:

- Është monitoruar temperatura e magazinimit të lëndëve të para dhe produkteve ushqimore dy herë në ditë, me rezultate të vazhdueshme brenda kufijve të përcaktuar.
- Janë kryer kontrolle të rregullta të temperaturës në dhomat e parapërgatitjes, duke konstatuar respektim të plotë të parametrave të kërkuar.
- Janë zhvilluar auditime periodike të higjienës personale të stafit, me nivel pajtueshmërie prej 100% me procedurat dhe protokollet e higjienës.
- Janë marrë dhe analizuar mostra mikrobiologjike të ushqimit sipas planit të monitorimit, pa u konstatuar ndonjë kontaminim mikrobiologjik.
- Janë realizuar analiza fiziko-kimike të produkteve ushqimore sipas nevojës, me rezultate që kanë përmbushur kërkesat e standardeve në fuqi.

- Janë marrë mostra për analiza fiziko-kimike dhe mikrobiologjike të ujit, të cilat kanë konfirmuar se uji i përdorur në procesin e prodhimit është i pijshëm dhe plotëson kriteret për përdorim në industrinë ushqimore.
- Gjatë pranimit të mishit të freskët janë kryer kontrollet organoleptike, verifikimi i certifikatave veterinare dhe kontrolli i vulosjes, pa u evidentuar mospërputhje.
- Janë realizuar aktivitetet e dezinfektimit, dezinsektimit dhe deratizimit (DDD), në përputhje me planin e mirëmbajtjes higjieno-sanitare.
- Është instaluar llampa UV për rritjen e nivelit të sigurisë higjienike në hapësirat e prodhimit.
- Është vendosur barriera për dezinfektimin e këpucëve në hyrje të zonave të prodhimit, si masë shtesë për parandalimin e kontaminimit.
- Janë verifikuar librezat sanitare të stafit dhe vlefshmëria e kontrolleve shëndetësore, duke rezultuar në pajtueshmëri të plotë.

Përmbledhje e treguesve të performancës

Aktiviteti	Frekuenca	Rezultati	Vlerësimi
Kontrolli i temperaturës së magazinimit	2 herë në ditë	Brenda normave	Përmbushur
Kontrolli i temperaturës në dhomat e parapërgatitjes	2 herë në ditë	Brenda normave	Përmbushur
Kontrolli i higjienës së stafit	2 herë në muaj	100% pajtueshmëri	Përmbushur
Inspektimi i pajisjeve të kuzhinës	2 herë në javë	95% funksionalitet	Kërkohet mirëmbajtje për një pjesë të pajisjeve
Inspektimi i pastrimit gjeneral	1 herë në javë	Brenda standardeve	Përmbushur
Marrja e mostrave të ushqimit	26 mostra në ditë	Brenda normave	Përmbushur
Analizat mikrobiologjike të ushqimit	2 herë në muaj	Pa kontaminime	Përmbushur
Analizat fiziko-kimike të ushqimit	Sipas nevojës	Brenda normave	Përmbushur
Analizat fiziko-kimike dhe mikrobiologjike të ujit	1 herë në tremujor	Ujë i pijshëm, pa kontaminime	Përmbushur
Kontrolli i mishit të freskët gjatë pranimit	1–2 herë në javë	Brenda standardeve	Përmbushur

Vlerësimi i përgjithshëm

Bazuar në monitorimet, analizat laboratorike dhe inspektimet e realizuara gjatë tremujorit, niveli i kontrollit të cilësisë dhe sigurisë ushqimore në NPL Ku'zina sh.a. vlerësohet i kënaqshëm. Nuk janë evidentuar raste të kontaminimit të ushqimit apo të ujit, ndërsa të gjithë parametrat kritikë të monitoruar kanë rezultuar brenda kufijve të lejuar. Gjithashtu, masat e ndërmarra për përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare kanë kontribuar në forcimin e sistemit të kontrollit dhe parandalimin e rreziqeve potenciale.

Prioritetet për tremujorin e ardhshëm

Për tremujorin e dytë planifikohet:

- rishikimi i kushteve të transportit të lëndëve të para me fokus në ruajtjen e zinxhirit të ftohtë;
- zgjerimi i menusë me shujta dietike dhe menu të veçanta sipas nevojave të konsumatorëve;
- realizimi i mirëmbajtjes parandaluese dhe investimeve në pajisje të reja të kuzhinës;
- organizimi i trajnimeve shtesë për menaxhimin e mbetjeve ushqimore dhe rritjen e efikasitetit të prodhimit;
- intensifikimi i kontrolleve të brendshme në kuzhinat e shkollave dhe kopshteve për të siguruar zbatim të njëtrajtshëm të standardeve të sigurisë ushqimore dhe procedurave operative.

DEPARTAMENTI I SHËRBIMEVE TË PËRBASHKËTA

Përmbledhje e aktiviteteve

Gjatë tremujorit të parë, Departamenti i Shërbimeve të Përbashkëta ka realizuar aktivitetet e planifikuara në funksion të mbështetjes operative dhe administrative të proceseve të punës në NPL Ku'zina sh.a., duke siguruar funksionimin e pandërprerë të shërbimeve ndaj institucioneve përfituese.

Në përputhje me rregulloret e brendshme të ndërmarrjes dhe kontratën për ofrimin e shërbimeve me Komunën e Prishtinës, departamenti ka administruar procesin e evidentimit të shujtave të shpërndara në institucionet parashkollore, ka përgatitur specifikimet mujore dhe, në bashkëpunim me Departamentin e Financave, ka realizuar faturimin e rregullt ndaj Komunës së Prishtinës.

Gjatë periudhës raportuese janë përgatitur specifikimet për aneks-kontratën, përmes së cilës janë zgjeruar shërbimet e ndërmarrjes me furnizimin me ushqim për Qendrën e të Moshuarve dhe Brigadën e Zjarrfikësve. Njëkohësisht është vazhduar ofrimi i shërbimeve për përfituesit e rasteve sociale në qendrat sociale "Aktash" dhe "Tophane".

Departamenti ka koordinuar me sukses shpërndarjen e shujtave në pesë shkollat fillore të përfshira në programin e mësimit tërëditor. Përveç transportit të ushqimit, stafi i shpërndarjes ka ofruar mbështetje gjatë procesit të shërbimit në shkolla, në koordinim të vazhdueshëm me koordinatorin përgjegjës të ndërmarrjes.

Në aspektin e menaxhimit të burimeve njerëzore, gjatë këtij tremujori nuk janë evidentuar lëvizje të stafit, duke mundësuar stabilitet organizativ dhe realizimin e të gjitha obligimeve operative sipas planifikimit.

Departamenti ka vazhduar monitorimin e gjendjes teknike të automjeteve për transportin e ushqimit, në bashkëpunim me zyrtarin përgjegjës për autoparkun. Janë identifikuar nevojat për mirëmbajtje dhe janë ndërmarrë ndërhyrjet e nevojshme për garantimin e funksionalitetit të mjeteve transportuese.

Gjithashtu është organizuar mirëmbajtja e rregullt e hapësirave të jashtme të ndërmarrjes përmes një plani javor të angazhimit të stafit, me qëllim ruajtjen e pastërtisë dhe funksionalitetit të ambientit të punës.

Treguesit kryesorë të performancës

Aktiviteti	**Rezultati gjatë TM1**
Regjistrimi dhe faturimi i shujtave	Realizuar sipas planit
Furnizimi i institucioneve parashkollore	I realizuar pa ndërprerje
Furnizimi i pesë shkollave me mësim tëreditor	I realizuar sipas planit
Furnizimi i Qendrës së të Moshuarve	I realizuar
Furnizimi i Brigadës së Zjarrfikësve	I realizuar
Furnizimi i dy qendrave sociale	I realizuar
Lëvizja e stafit	Nuk ka pasur ndryshime
Monitorimi i autoparkut	Realizuar në mënyrë të vazhdueshme
Mirëmbajtja e hapësirave të jashtme	Realizuar sipas planit

Vlerësimi i përgjithshëm

Departamenti i Shërbimeve të Përbashkëta ka përmbushur me sukses objektivat e planifikuara për tremujorin e parë, duke ofruar mbështetje të vazhdueshme për proceset operative, logjistike dhe administrative të ndërmarrjes. Bashkëpunimi me departamentet e tjera organizative ka qenë i mirë, ndërsa organizimi i shërbimeve në institucionet përfituese është zhvilluar pa ndërprerje dhe në përputhje me planifikimet operative.

Prioritetet për TM2

- Përgatitja e aktiviteteve për vazhdimin e kontratës me Komunën e Prishtinës.
- Përmirësimi i koordinimit të proceseve të shpërndarjes së shujtave.
- Vazhdimi i mirëmbajtjes parandaluese të automjeteve dhe pajisjeve logjistike.
- Rritja e monitorimit të performancës së stafit dhe zbatimit të përgjegjësive.
- Përmirësimi i organizimit të shërbimeve mbështetëse dhe infrastrukturës së ndërmarrjes.
- Vazhdimi i bashkëpunimit ndërmjet departamenteve për rritjen e efikasitetit operacional dhe cilësisë së shërbimeve.

PROKURIMI

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2026, Njësia e Prokurimit ka zhvilluar aktivitetet në përputhje me Planin Vjetor të Prokurimit, duke siguruar realizimin e procedurave të nevojshme për mbështetjen e proceseve operative të NPL Ku'zina sh.a.

Gjatë periudhës raportuese janë përfunduar dhe nënshkruar kontrata për furnizimin me produkte ushqimore dhe pajisje, të nevojshme për funksionimin e ndërmarrjes. Njëkohësisht janë iniciuar procedura të reja të prokurimit për mallra dhe shërbime, si dhe është vazhduar përgatitja e dokumentacionit teknik për procedurat e planifikuara gjatë vitit.

Një nga aktivitetet kryesore të këtij tremujori ishte ndërprerja e kontratës ekzistuese për furnizim me bukë dhe produkte të brumit, e administruar përmes kontratës së centralizuar të AQP-së, për shkak të numrit të konsiderueshëm të ankesave të pranuara nga institucionet parashkollore lidhur me cilësinë e produkteve të furnizuara. Pas vlerësimit profesional dhe rekomandimit të teknologes së ndërmarrjes, u iniciua procedurë e re e negociuar me qëllim sigurimin e cilësisë më të lartë të produkteve dhe vazhdimësinë e furnizimit.

Kontratat e nënshkruara gjatë TM1

Nr.	Numri i procedurës	Përshkrimi	Vlera (€)
1	KQ-25-10948-1-2-1	Furnizim me drithëra për institucionet parashkollore	28,529.00
2	KQ-26-385-1-4-7	Furnizim dhe instalim i telefonave fiks për zyra	700.00
3	KQ-26-311-1-3-6	Furnizim me pajisje TV	4,000.00
4	KQ-26-879-1-3-6	Furnizim dhe montim i roletave	2,539.00
5	Procedurë e negociuar	Furnizim me bukë dhe produkte të tjera të brumit	196,942.50

Vlera totale e kontratave të nënshkruara gjatë TM1: 232,710.50 €

Procedurat e iniciuara

Gjatë tremujorit janë iniciuar procedurat e mëposhtme të prokurimit:

Procedura	Vlera e parashikuar (€)	Statusi
Furnizim me material shpenzues për zyra	7,000.00	Në procedurë
Auditimi i pasqyrave financiare	980.00	Në procedurë
Furnizim me paketime ushqimore	Në përgatitje	Hartimi i specifikimeve teknike

Treguesit kryesorë të performancës

Treguesi	Rezultati TM1
Kontrata të nënshkruara	5
Procedura të iniciuara	3

Vlera totale e kontratave të nënshkruara	232,710.50 €
Procedura të negociuara	1
Procedura në fazën e përgatitjes	1

Vlerësimi i përgjithshëm

Gjatë tremujorit të parë, Njësia e Prokurimit ka realizuar me sukses aktivitetet e planifikuara, duke siguruar furnizimin në kohë me mallra dhe pajisje të nevojshme për funksionimin e ndërmarrjes. Reagimi i shpejtë ndaj ankesave për cilësinë e bukës dhe inicimi i një procedure të re të prokurimit dëshmon angazhimin e ndërmarrjes për garantimin e cilësisë së produkteve ushqimore dhe mbrojtjen e interesit të përfituesve të shërbimeve.

Prioritetet për TM2

Për tremujorin e dytë planifikohet:

- përfundimi i procedurave të iniciuara gjatë TM1;
- finalizimi i procedurës për furnizim me paketime ushqimore;
- monitorimi i zbatimit të kontratave të nënshkruara dhe performancës së operatorëve ekonomikë;
- përgatitja dhe inicimi i procedurave të parapara në Planin Vjetor të Prokurimit;
- forcimi i kontrollit të cilësisë së mallrave dhe shërbimeve të pranuara, me qëllim sigurimin e përmbushjes së kërkesave teknike dhe standardeve të ndërmarrjes.

ZYRA E BURIMEVE NJERËZORE

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2026, Zyra e Burimeve Njerëzore ka zhvilluar aktivitetet e saj në funksion të sigurimit të një strukture organizative efikase, menaxhimit të lëvizjeve të stafit dhe zhvillimit profesional të punonjësve.

Në zbatim të Rregullores për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Sistematizimin e Punëve dhe Detyrave të Punës (Nr. Prot. 0360, datë 26.02.2024), janë ndërmarrë masa për optimizimin e shpërndarjes së burimeve njerëzore, me qëllim përballimin e rritjes së volumit të punës, veçanërisht në Departamentin e Prodhimit dhe Departamentin e Shitjes dhe Marketingut.

Lëvizjet e stafit

Për të balancuar ngarkesën e punës dhe për të rritur efikasitetin operacional, gjatë periudhës raportuese janë realizuar transferimet e mëposhtme:

Lëvizja	**Numri**
Nga Zyrtar i Distribuimit në Zyrtar për Furnizim	1
Nga Kuzhinier në Agjent i Shitjes	1
Nga Zyrtar për Arkiv në Agjent i Shitjes	1

Gjithsej gjatë TM1 janë realizuar **7 transferime të brendshme**, duke mundësuar shfrytëzim më racional të kapaciteteve njerëzore dhe mbështetje për departamentet me ngarkesë më të lartë pune.

Punësimet e reja

Gjatë tremujorit janë angazhuar **3 punonjës të rinj**, në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve dhe forcimit të kapaciteteve organizative.

Trajnimet dhe zhvillimi profesional

Gjatë TM1 është vazhduar realizimi i një pjese të programit të trajnimeve të planifikuara gjatë vitit 2025 për stafin e kuzhinës.

Trajnimet kanë përfshirë temat në vijim:

- Matjen e kushteve mikroklimatike (temperatura dhe lagështia e ajrit);
- Matjen e ndriçimit në vendin e punës;
- Matjen e nivelit të zhurmës;
- Shqyrtimin e tokëzimit të pajisjeve;
- Verifikimin e tokëzimit mbrojtës të prizave elektrike;
- Aktin e Vlerësimit të Riskut në Vendin e Punës.

Njëkohësisht është planifikuar fillimi i një programi të integruar profesional për zhvillimin e kapaciteteve të stafit, i cili do të kombinojë trajnim, mentorim dhe konsulencë profesionale me qëllim:

- përmirësimin e proceseve të sigurisë ushqimore;
- ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit;
- përgatitjen e Kuzhinës Qendrore të Prishtinës për certifikimin sipas standardeve HACCP dhe ISO 22000.

Programi do të përfshijë trajnim teorik, mentorim praktik në vendin e punës dhe konsulencë profesionale, duke synuar zbatim të qëndrueshëm të standardeve ndërkombëtare të sigurisë ushqimore.

Treguesit kryesorë të performancës

Treguesi	Rezultati TM1
Transferime të brendshme	7
Punësime të reja	3
Programet e trajnimit të realizuara	Vazhdim i planit 2025
Programi HACCP dhe ISO 22000	Në fazën e planifikimit

Vlerësimi i përgjithshëm

Gjatë tremujorit të parë, Zyra e Burimeve Njerëzore ka kontribuar në optimizimin e strukturës organizative përmes rishpërndarjes së stafit dhe plotësimit të pozitave të nevojshme, duke mbështetur funksionimin efikas të departamenteve operative. Paralelisht, është vazhduar investimi në zhvillimin profesional të punonjësve përmes programeve të trajnimit dhe është planifikuar zbatimi i një programi gjithëpërfshirës për ngritjen e standardeve profesionale dhe përgatitjen për certifikimin HACCP dhe ISO 22000.

Prioritetet për TM2

Për tremujorin e dytë planifikohet:

- zbatimi i programit të integruar të trajnimit, mentorimit dhe konsulencës për certifikimin HACCP dhe ISO 22000;
- vazhdimi i zhvillimit profesional të stafit në përputhje me nevojat e ndërmarrjes;
- organizimi i trajnimeve për menaxhimin e kontratave për stafin përgjegjës, me qëllim rritjen e kapaciteteve në administrimin dhe monitorimin e kontratave;
- përmirësimi i planifikimit të burimeve njerëzore në përputhje me rritjen e vëllimit të punës;
- forcimi i sistemit të vlerësimit të performancës dhe zhvillimit profesional të punonjësve.

Trajnimi për menaxhimin e kontratave pritet të kontribuojë në rritjen e transparencës, minimizimin e rreziqeve kontraktuale, sigurimin e përputhshmërisë me kërkesat ligjore dhe procedurat e brendshme, si dhe në përmirësimin e përgjithshëm të performancës institucionale në administrimin e kontratave.

VËZHGIMI NË TERREN NË ÇERDHE DHE SHKOLLA

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2026 janë realizuar vizita dhe vëzhgime të rregullta në terren në çerdhe dhe shkolla, me qëllim monitorimin e zbatimit të standardeve të shërbimit, respektimit të procedurave operative dhe identifikimit të nevojave për përmirësim.

Përveç monitorimit në terren, janë zhvilluar konsultime të vazhdueshme me stafin në pikat e shërbimit, duke kontribuar në përmirësimin e organizimit të punës, koordinimit ndërmjet ekipeve dhe zbatimit të procedurave operative. Në përgjithësi është evidentuar progres në cilësinë e shërbimeve, ndërsa disa sfida vazhdojnë të lidhen me kushtet infrastrukturore të hapësirave të servimit në një numër të kufizuar shkollash.

Aktivitetet dhe rezultatet e arritura

Gjatë periudhës raportuese janë arritur rezultatet në vijim:

- është përmirësuar niveli i higjienës personale të stafit dhe respektimi i praktikave higjieno-sanitare;
- është rritur niveli i respektimit të uniformës zyrtare dhe orarit të punës;
- është përfunduar pajisja e stafit me uniforma në të gjitha pikat e shërbimit;

- është përmirësuar raportimi në kohë i mungesave, vonesave dhe ndryshimeve në orarin e punës;
- është siguruar evidentimi dhe dorëzimi i rregullt i dokumentacionit për Zyrën e Burimeve Njerëzore;
- është organizuar puna sipas sistemit të rotacionit, në përputhje me nevojat operative;
- është përmirësuar procesi i shpërndarjes së ushqimit, duke siguruar shpërndarje më të barabartë të porcioneve.

Masat e ndërmarra

Për përmirësimin e organizimit të punës dhe cilësisë së shërbimit janë ndërmarrë këto masa:

- është filluar implementimi i orarit të ri të punës në institucionet parashkollore (4 ditë pune dhe 3 ditë pushim);
- janë hartuar oraret e punës në përputhje me numrin e stafit dhe numrin e shujtave në secilën pikë të shërbimit;
- është kërkuar rritja e kontrollit gjatë pranimit të shujtave, duke përfshirë verifikimin e cilësisë, sasisë, higjienës dhe afatit të përdorimit;
- është zbatuar procedura e provimit (degustimit) të ushqimit para servimit;
- janë zhvilluar konsultime të vazhdueshme me stafin lidhur me pranimin e shujtave, mënyrën e servimit dhe pastrimin përfundimtar të hapësirave të kuzhinës.

Treguesit kryesorë të performancës

Treguesi	**Rezultati TM1**
Vizita monitoruese në terren	Të realizuara sipas planit
Pajisja e stafit me uniforma	100% e përfunduar
Implementimi i orarit të ri në çerdhe	I filluar
Raportimi i mungesave dhe ndryshimeve	Në kohë
Organizimi i punës me rotacion	I zbatuar sipas nevojës
Përmirësimi i shpërndarjes së porcioneve	I evidentuar
Konsultimet me stafin	Të realizuara në vazhdimësi

Sfidat dhe çështjet që kërkojnë vëmendje

Megjithëse është evidentuar përmirësim i përgjithshëm në organizimin e punës dhe cilësinë e shërbimit, gjatë monitorimeve janë identifikuar disa sfida që kërkojnë trajtim të vazhdueshëm.

Në disa shkolla vazhdojnë të ekzistojnë kushte infrastrukturore jo të favorshme për servimin e ushqimit, të cilat kufizojnë zbatimin optimal të standardeve higjieno-sanitare dhe paraqesin rrezik

potencial për sigurinë ushqimore. Përmirësimi i këtyre kushteve kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm me institucionet përgjegjëse dhe planifikim të investimeve sipas prioriteteve.

Vlerësimi i përgjithshëm

Vëzhgimet e realizuara gjatë tremujorit të parë tregojnë një përmirësim të dukshëm në organizimin e punës, disiplinën e stafit dhe cilësinë e shërbimit në çerdhe dhe shkolla. Masat e ndërmarra kanë ndikuar pozitivisht në standardizimin e proceseve operative, ndërsa monitorimi i vazhdueshëm në terren ka mundësuar identifikimin dhe adresimin në kohë të mangësive operative.

Prioritetet për TM2

Për tremujorin e dytë planifikohet:

- monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të orarit të ri të punës në institucionet parashkollore;
- vazhdimi i këshillimit dhe mbështetjes profesionale të stafit për menaxhimin dhe servimin e ushqimit;
- intensifikimi i kontrolleve higjieno-sanitare në shkolla dhe çerdhe;
- identifikimi dhe adresimi i mangësive infrastrukturore në hapësirat e servimit, në bashkëpunim me institucionet përkatëse;
- standardizimi i mëtejshëm i praktikave të punës në të gjitha pikat e shërbimit;
- monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimit dhe zbatimit të procedurave operative, me qëllim rritjen e sigurisë ushqimore dhe kënaqshmërisë së përfituesve të shërbimeve.

MENAXHIMI I KONTRATAVE

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2026, Zyra për Menaxhimin e Kontratave ka realizuar aktivitetet e planifikuara për monitorimin, administrimin dhe vlerësimin e kontratave aktive, me qëllim sigurimin e zbatimit të tyre në përputhje me kushtet kontraktuale, kërkesat ligjore dhe nevojat operative të NPL Ku'zina sh.a.

Fokusi i punës ka qenë monitorimi i performancës së operatorëve ekonomikë, verifikimi i dokumentacionit mbështetës, administrimi i pagesave kontraktuale dhe analiza e kostove të furnizimeve dhe shërbimeve.

Aktivitetet e realizuara

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar aktivitetet në vijim:

- monitorimi i zbatimit të kontratave aktive dhe verifikimi i përmbushjes së obligimeve kontraktuale;
- shqyrtimi dhe analiza e kontratave aktive dhe të përfunduara;
- përgatitja e raporteve periodike mbi performancën e kontratave;
- verifikimi i specifikimeve të faturave dhe fletë-dërgesave;
- konstatimi dhe certifikimi i pagesave për **27 kontrata** aktive dhe të përfunduara;

- evidentimi dhe arkivimi i dokumentacionit mbështetës të pranuar nga menaxherët e kontratave;
- koordinimi me njësitë përkatëse për monitorimin e realizimit të kontratave.

Analiza financiare e kontratave

Gjatë TM1 2026 ndërmarrja ka zhvilluar aktivitete furnizimi dhe shërbimi me 25 operatorë ekonomikë, të klasifikuar në katër kategori kryesore:

1. Kontrata të furnizimit të administruara nga Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP);
2. Kontrata të furnizimit të realizuara nga Zyra e Prokurimit e NPL Ku'zina sh.a.;
3. Kontrata për shërbime;
4. Marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe lokale.

Analiza financiare ka shërbyer për vlerësimin e kostos së furnizimeve, krahasimin me periudhat paraprake dhe identifikimin e ndryshimeve në strukturën e shpenzimeve.

Analiza krahasuese e kontratave me AQP

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, vlera e furnizimeve përmes kontratave të AQP-së është rritur nga **116,196.60 €** në **124,301.75 €**, që përfaqëson një rritje prej **8,105.15 €** ose **6.98%**.

Aktivitetet tjera

Gjatë TM1 janë realizuar edhe këto aktivitete:

- janë nënshkruar **3 kontrata afatshkurtra** dhe **1 kontratë afatgjatë**, për:
  - furnizim me pajisje TV;
  - furnizim dhe montim të roletave;
  - furnizim me telefona fiks;
  - pajisje të teknologjisë informative me qira.
- janë përditësuar në sistemin elektronik të prokurimit (KRPP/e-Prokurimi) raportet për kontratat e përfunduara, në përputhje me procedurat për menaxhimin dhe mbylljen e kontratave;
- janë iniciuar procedurat për dy kontrata të reja:
  - furnizim me paketime ushqimore;
  - furnizim me material shpenzues për zyra.
- kontrata për furnizim me paketime ushqimore me operatorin ekonomik përkatës është përfunduar para afatit, për shkak të konsumimit të plotë të sasisë së kontraktuar nga nevojat e shkollës "Zenel Hajdini".

Vlerësimi i përgjithshëm

Gjatë tremujorit të parë është siguruar monitorim i vazhdueshëm i kontratave aktive dhe administrim i rregullt i dokumentacionit kontraktual. Analizat financiare kanë mundësuar identifikimin e ndryshimeve në strukturën e furnizimeve dhe vlerësimin e performancës së operatorëve ekonomikë, duke ofruar bazë për planifikimin e aktiviteteve të ardhshme dhe optimizimin e shpenzimeve.

Prioritetet për TM2

Për tremujorin e dytë planifikohet:

- vazhdimi i monitorimit sistematik të zbatimit të kontratave aktive;
- përfundimi i procedurave të iniciuara gjatë TM1;
- përmirësimi i analizës së performancës së operatorëve ekonomikë përmes treguesve të matshëm të performancës;
- forcimi i kontrollit mbi realizimin e kontratave dhe dokumentacionin mbështetës;
- përditësimi i vazhdueshëm i të dhënave në sistemin elektronik të prokurimit;
- identifikimi dhe menaxhimi në kohë i rreziqeve kontraktuale, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe transparencës në administrimin e kontratave.

PËRFUNDIME

Gjatë Tremujorit të Parë (TM1) të vitit 2026, NPL Ku'zina sh.a. ka realizuar me sukses objektivat e planifikuara, duke dëshmuar progres të qëndrueshëm në aspektin financiar, operacional dhe organizativ. Rezultatet e arritura konfirmojnë se ndërmarrja ka vazhduar të konsolidojë pozitën e saj si ofrues i besueshëm i shërbimeve të ushqimit për institucionet publike të Kryeqytetit, duke ruajtur standarde të larta të cilësisë, sigurisë ushqimore dhe përgjegjshmërisë institucionale.

Gjatë kësaj periudhe është evidentuar rritje e konsiderueshme e të hyrave dhe e vëllimit të shërbimeve, e ndikuar kryesisht nga zgjerimi i programit të mësimit tërë ditor në shkollat fillore dhe rritja e kërkesës për shërbimet që ofron ndërmarrja. Krahas kësaj, menaxhimi i kujdesshëm i burimeve financiare dhe monitorimi i vazhdueshëm i shpenzimeve kanë kontribuar në ruajtjen e stabilitetit financiar dhe përmirësimin e efikasitetit operacional.

Në fushën e prodhimit dhe shpërndarjes së ushqimit, ndërmarrja ka siguruar furnizim të rregullt dhe cilësor për të gjitha institucionet përfituese, duke garantuar vazhdimësi të shërbimeve dhe respektim të standardeve të përcaktuara. Sistemi i kontrollit të cilësisë dhe procedurat e sigurisë ushqimore janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme, ndërsa monitorimet laboratorike dhe kontrollet higjieno-sanitare kanë konfirmuar përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe standardet profesionale.

Njëkohësisht, janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në forcimin e proceseve të prokurimit dhe menaxhimit të kontratave, përmes monitorimit të performancës së operatorëve ekonomikë, analizimit të kostove dhe ndërmarrjes së masave korrigjuese kur ka qenë e nevojshme. Këto veprime kanë ndikuar në rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë dhe efikasitetit në administrimin e kontratave.

Në aspektin organizativ, ndërmarrja ka vazhduar investimin në zhvillimin e burimeve njerëzore, përmirësimin e proceseve të punës dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit. Monitorimet e

realizuara në institucionet përfituese kanë ndihmuar në identifikimin e sfidave operative dhe në ndërmarrjen e masave konkrete për përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe standardizimin e proceseve të punës.

Megjithëse gjatë periudhës raportuese janë evidentuar sfida që lidhen me rritjen e kostove të lëndëve të para, zgjerimin e vazhdueshëm të kërkesës për shërbime dhe nevojën për investime shtesë në pajisje dhe infrastrukturë, ndërmarrja ka demonstruar kapacitet të mirë menaxhues për t'iu përgjigjur këtyre sfidave pa cenuar vazhdimësinë dhe cilësinë e shërbimeve.

Duke parë rezultatet e arritura dhe trendin pozitiv të zhvillimit, menaxhmenti vlerëson se NPL Ku'zina sh.a. ka krijuar baza të forta për realizimin e objektivave strategjike gjatë vitit 2026. Në tremujorin vijues, fokusi do të jetë në avancimin e mëtejshëm të sistemit të menaxhimit të sigurisë ushqimore, përgatitjen për certifikim sipas standardeve HACCP dhe ISO 22000, zgjerimin e kapaciteteve prodhuese, investimet në modernizimin e pajisjeve dhe digjitalizimin e proceseve, si dhe në forcimin e monitorimit të performancës dhe cilësisë së shërbimeve.

Menaxhmenti i NPL Ku'zina sh.a. mbetet i përkushtuar për të vazhduar zhvillimin e ndërmarrjes mbi parimet e profesionalizmit, transparencës, efikasitetit dhe llogaridhënies, me synim ofrimin e shërbimeve cilësore, të sigurta dhe të qëndrueshme për të gjithë përfituesit dhe qytetarët e Kryeqytetit.